

VENDIM
Nr. 483, datë 30.7.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 355, DATË 20.4.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN E PRONËS
SHTETËRORE, NË ZONËN KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA
ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË, NË FONDIN E PASURIVE TË
PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE, DHE
VËNIEN NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E
PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK ‘NGRITJA E PLANTACIONIT ME
SHEGË, *GOJI BERRY*, AVOKADO DHE *FINGER LIME*, NË ZONËN E
KARAVASTASË, BASHKIA DIVJAKË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 355, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe në pikat 2, 4 dhe 5, fjalët “Ngritja e plantacionit me shegë *goji berry*, avokado dhe *finger lime*, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë” zëvendësohen me “Ngritja e plantacionit me shegë, *goji berry*, kivi, rrush, dardhë etj., si dhe zhvillimin e agroturizimit në një sipërfaqe rreth 131 ha, në zonën e Karavastasë, Bashkia Divjakë”.

2. Në pikën 3, pas fjalëve “... nr. 6/4, datë 19.4.2018, të Komitetit të Investimeve Strategjike” shtohen fjalët “... ndryshuar me vendimin nr. 6/9, datë 24.6.2020, të Komitetit të Investimeve Strategjike”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe